

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbushi Europën me ko*ainë, kush është Shpëtim Aliu, personi kyç i hetimeve të SPAK - Informohu siç d uhet
ADRESA	https://radar.al/mbushi-europen-me-koaine-kush-eshte-shpetim-aliu-personi-kyc-i-hetimeve-te-spak/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:16:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 19:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8c7d2a3e17802dee302d9aafcd315044d1cacfade0e75339c03ad68d182dcfe
TEKSTI	d8bf4a85089869492348cd9801e61055c0b64c3a9dfe655e69e69a703836e9a6
PAMJA	47b74419dd520c0886384050da9de74cfcee2deaf902c5143d78b8c195ca0c54

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0b48007fcc59275b4d1db388dedee8e6c374dbec39625cb2af71e7e2348243b3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/0b48007fcc59275b4d1db388dedee8e6c374dbec39625cb2af71e7e2348243b3

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Mbushi Europën me ko*ainë, kush është Shpëtim Aliu, personi kyç i hetimeve të SPAK

AKTUALITET

Demo

Mbushi Europën me ko*ainë, kush është Shpëtim Aliu, personi kyç i hetimeve të SPAK

SEPTEMBER 23, 2026



Shpëtim Aliu, i njohur me aliasin "Salvatore", është një nga personat e akuzuar nga SPAK për rolin e tij në një rrjet të gjerë të trafikut ndërkombëtar të kokainës. Aliu, i cili u arrestua në Rusi në kuadër të një operacioni ndërkombëtar të Interpol Tiranës, ishte shpallur në kërkim nga drejtësia shqiptare pas hetimeve të zhvilluara nga Prokuroria e Posaçme.

Sipas të dhënave të hetimit të SPAK, Aliu dyshohet se ka pasur një rol qendror në skemën e trafikimit të lëndëve narkotike, duke shërbyer si një prej hallkave furnizuese të rrjetit. Ai dyshohet se ka furnizuar me kokainë grupet kriminale të lidhura me Shpëtim Gjickën, Eldi Dizdarin dhe Armando Pacanin.

Hetimi i SPAK, i zhvilluar mbi aktivitetin e këtij grupi kriminal, ka dokumentuar pesë episode të trafikimit të sasive të mëdha të kokainës, ndërsa në total janë sekuestruar 8 tonë e 960 kilogramë lëndë narkotike.

Në kuadër të hetimeve, në zbatim të vendimeve gjyqësore, janë kryer 23 kontrolle në banesa, zyra të shoqërive tregtare dhe ambiente të tjera të lidhura me personat nën hetim. Sipas SPAK, provat e mbledhura kanë dokumentuar pesë episode të trafikimit të kokainës në sasi të mëdha.

Episodi i parë lidhet me datën 11 maj 2020, kur në portin e Waasland, në Antuerp të Belgjikës, u sekuestruan 700 kilogramë kokainë. Droga ishte fshehur në një kontejner me pjesë këmbimi automjesh, i cili kishte mbërritur me një anije nga Kina.

Më 6 qershor 2020, në Guayaquil të Ekuadorit u sekuestruan 2 tonë e 10 kilogramë kokainë, e cila dyshohej se kishte si destinacion përfundimtar Holandën. Sasia e drogës kishte të stampuara tre logo të ndryshme: "Jaguar", "Shqiponjë" dhe "BB".

Episodi i tretë është regjistruar më 16 gusht 2020, kur në Rotterdam të Holandës u sekuestruan 1.1 tonë kokainë. Sipas hetimeve, ngarkesa kishte mbërritur në port me një anije që ishte nisur nga Guayaquil i Ekuadorit.

Katër muaj më vonë, më 16 dhjetor 2020, autoritetet sekuestruan në portin e Roterdamit një tjetër ngarkesë të konsiderueshme, prej 4.1 tonësh kokainë. Edhe kjo ngarkesë kishte mbërritur me rrugë detare nga porti i Guayaquil.

Episodi i pestë lidhet me 3 shkurtin 2021, kur në Kolumbi u sekuestruan 1 ton e 50 kilogramë kokainë, e cila kishte si destinacion final Francën.

Sipas SPAK, hetimet kanë zbuluar se përveç pesë episodeve të dokumentuara, anëtarët e grupit kriminal dyshohet se kanë trafikuar nga Amerika Latine drejt vendeve europiane edhe dhjetëra tonelata të tjera kokainë. Lënda narkotike dyshohet se më pas është trafikuar dhe tregtuar te persona të tjerë, duke gjeneruar të ardhura të konsiderueshme.

Shpëtim Aliu ishte një prej personave të nërfshirë në hetimet e SPAK të nisura dhe të finalizuara me

Postimet e reja

Kush është, 25-vjeçari shqiptar që përplasi kat...

SEPTEMBER 23, 2026

Mbushi Europën me ko*ainë, kush është...

SEPTEMBER 23, 2026

Arrestohet në Rusi një nga personat më të kërkuar...

SEPTEMBER 23, 2026

E ardhmja e Merz nën presion, 45% e...

SEPTEMBER 23, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 22, 2026

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits" të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Situata financiare e një prej ish-gjigantëve të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve, "Top Fruits",...

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznes të paktën 1-vjeçare

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Na ndiq

aksionet e qershorit 2026 ndaj grupeve të dyshuara për trafik ndërkombëtar të kokainës. Për të, Gjykata e Posaçme ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Arrestimi i tij në Rusi pritet të pasohet nga procedurat për ekstradimin drejt Shqipërisë, ku ai do të përballlet me akuzat e ngritura nga autoritetet shqiptare.

Shpetim Aliu

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri: Horoskopi për të gjitha shenjat



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.